



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Doretuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	07-12-3 2023	viti god year	
Organ /Njesia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPS/SHCK	7350/2023		1/9



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1266/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-Kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1266/2023 të datës 10.10.2023 të parashtruar nga ankuesja me adresë: rrugë , Prishtinë, kundër Vendimit me numër protokollit Nr.2941 të datës 11.09.2023 të Komisionit për Vlerësimin për Ngritje në Detyrë në Ministrinë e Ekonomisë, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1266/2023 e datës 10.10.2023 e parashtruar nga ankuesja .

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokollit Nr.prot.2941 i datës 11.09.2023 i Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë i Ministrisë së Ekonomisë.

A r s y e t i m

Ministria e Ekonomisë në bazë të Ligjit me numër Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenin 39 paragrafin (1,2 dhe 3) si dhe nenin 52 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për pranim në Karrierën në Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, më datë 24.05.2023 ka publikuar Konkursin me numër reference Nr.RN00011647 për ngritje (avancim) në detyrë për pozitën e punës „Udhëheqës i Divizionit për Mbikëqyrjen dhe Zbatimin e Legjislacionit” në Departamentin Ligjor, Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjeve, Mbështetjes Ligjore dhe Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit, ku afati për aplikim ka qenë nga data 08.06.2023 deri më datë 15.06.2023, në të cilin konkurs kanë aplikuar pesë (5) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja e cila i është nënshtruar të gjitha fazave të procedurës (verifikimit paraprak, testit me shkrim, vlerësimit të

jetëshkrimit dhe intervistës me goje).

Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, më datë 31.08.2023, Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë ka publikuar Njoftimin për rezultatin përfundimtar me kandidaten D.K me gjithsejtë tetëdhjetë e shtatë e gjashtëdhjetë e shtatë (87.67) pikë të pergjithshme si kandidate fituese, ndërsa ankuesja nga të gjitha fazat e vlerësimit ka marrë gjithsejtë shtatëdhjetë e nëntë (79) pike duke u radhitur e treta (3) në liste.

Ankuesja kundër këtij njoftimi me datë 05.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit Nr.prot.2891 në Komisionin e Vlerësimit për ngritje në detyre në Ministrinë e Ekonomisë, ndërsa më datë 11.09.2023, Komisioni i Vlerësimit për ngritje në detyrë në Ministrinë e Ekonomisë ka nxjerr Vendim me numër protokollit Nr.prot.2941 përmes të cilit e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me numër protokollit Nr.2941 të datës 11.09.2023, të Komisionit të Vlerësimit për ngritje në detyrë në Ministrinë e Ekonomisë, më datë 10.10.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6476/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë e ankuese në Ministrinë e Ekonomisë. Ndërsa Këshilli nga kjo e fundit më datë 23.10.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër VK/2023 dhe numër të protokollit 7055/2023 të datës 22.11.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1266/2023 të parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit Nr.6476/2023 të datës 10.10.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër reference Nr.RN00011647 për ngritje (avancim) në detyrë të shpallur më datë 24.05.2023; Vendimin me numër protokollit Nr.prot.2242 të datës 05.07.2023 për themelimin e Komisionit të Pranimit; Ankesën me numër protokollit Nr.prot.2891 të datës 05.09.2023 të parashtruar nga ankuesja në Komisionin e Pranimit; Vendimin me numër protokollit Nr.prot.2941 të datës 11.09.2023; Punimin Shkencor me temën „ *The Legislative Aspect for the Economic Zones-Case of Kosovo*” me autorë H.J dhe M.B; Vendimin me numër protokollit Nr.prot.3133 të datës 29.09.2023; Punimin Shkencor me temën „*The Supremacy of International Agreements on the Legislation in Force*” Nëntor 2019 me autorë H.B-J dhe J.P-Sh; Certifikatën me numër protokollit Nr.prot.11/22 të datës 09.06.2023 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik; Diplomën me numër Nr.602 të lëshuar më datë 22.06.2009 nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik; Diplomën e Studimeve Postdiplomike-Master me numër Nr.242 të lëshuar më datë 25.05.2012 nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik; Certifikatën e datave 21.03.2023 dhe 24.03.2023 të lëshuar nga Center of Excellence in Finance; Certifikatën për periudhën kohore Maj 2013; Certifikatën me numër

Nr.872/12 të datës 05.12.2005 të lëshuar nga English Language Centre; Certifikatën e datës 29.05.2012 të lëshuar nga MDA; Certifikatën e datave 1,2 dhe 9 tetor 2018 të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike; Certifikatën e datës 12.11.2018 të lëshuar nga Universiteti i Pejës; Dëshmi e datës 19.06.2012; Certifikatën e datës 18.06.2022 të lëshuar nga USAID; Certifikatën qershor 2017 të lëshuar nga USAID dhe AUK; Certifikatën e datave 02-05 Mars 2020 të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike; Certifikatën e datave 23-24 Korrik 2012 të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike; Certifikatën e datës 16.02.2018, 19.02.2018 të lëshuar nga Prudencia Consulting; Certifikatën e datës 24.11.2007 të lëshuar nga ICD; Certifikatën e datave 12-13 shtator 2017 të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike; Certifikatën Maj 2013 të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike dhe GIZ; Certifikatën e datave 21,22,23 qershor 2016 të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike; Certifikatën e datave 13-14 tetor 2011 të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike; E-mailin e datës 17.09.2021; E-mailin e datës 14.09.2021; Dëshmi e datës 02.05.2006; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 17.10.2023; Përgjigje në ankesë e datës 23.10.2023; Listën e aplikantëve të aprovuar me numër reference RN00011647; Njoftimin me numër protokolli Nr.2101 të datës 21.06.2023; Vendimin me numër protokolli Nr.prot.2577 të datës 14.10.2013; Vendimin me numër protokolli Nr.prot.3114 të datës 29.09.2023; Ndryshimin dhe plotësimin e Akt Emërimit me numër From: MAP/AE/02 i datës 01.12.2016; E-mailat e datës 21.06.2023; Akt Emërimit me numër protokolli Nr.prot.75 të datës 03.03.2014; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 31.08.2023; Dëshmi për rezultatet e vlerësimit; Formularin për rezultatet e vlerësimit të kandidatëve nëpërmjet intervistës për ankuesen i datës 31.08.2023; Formularin për rezultatet e vlerësimit të kandidatëve nëpërmjet intervistës për D.K i datës 31.08.2023; Formularin për rezultatet e vlerësimit të kandidatëve nëpërmjet intervistës për A.M i datës 31.08.2023; Vendimin me numër protokolli Nr.prot.768 të datës 02.03.2023; Vendimin me numër Nr.prot. 1468 të datës 24.06.2022; Caktimin e Zëvendësueses për pozitën e Udhëheqëses së Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit, në kuadër të Departamentit Ligjor të datës 23.06.2022; Ndryshimin dhe plotësimin e Aktit të Emërimit me numër From: MAP/AE/02 të datës 02.02.2015; Ndryshimin dhe plotësimin e Aktit të Emërimit me numër From: MAP/AE/02 të datës 05.12.2011; Akt Emërimit e datës 01.09.2011; Kontratën e Marrëdhënies së Punës me numër Nr.115 të datës 01.09.2006; Kontratën e Marrëdhënies së Punës me numër Nr.115 të datës 02.09.2009; Kodin e Mirësjelljes për Nëpunësit Civil me numër Nr.01/2006; Kontratën e Marrëdhënies së Punës me numër Nr.115 të datës 01.09.2008; Kontratën për kryerjen e punëve të përkohshme të datës 26.07.2006; Kontratën për kryerjen e punëve të përkohshme të datës 02.05.2006; Kontratën e Marrëdhënies së Punës me numër Nr.115 të datës 20.10.2010; Kopje e letërnjoftimit; Formulari për vlerësimin e rezultateve në pune për periudhën Janar-Maj 2022 i datës 18.01.2013; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Qershor-Dhjetor i datës 23.01.2023; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë Drejtues i mesëm, i Ulët dhe Profesional i datës 26.01.2022; Kopjen e pasaportës; Vërtetimin e datës 08.06.2023; Aplikacionin e datës 13.06.2023; Diplomën për studimet postdiplomike me numër Nr.1354 të datës 24.03.2017 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik; Diplomën me numër Nr.2082 të lëshuar më datë 17.07.2013 nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik; Certifikatën e datës 03.11.2016 të lëshuar nga USAID dhe AUK; Certifikatën e datave 09-10 Mars 2016; Certifikatën e datave 25-26 janar 2016 të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike; Certifikatën e datave 02-03 dhjetor 2015 të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike; Certifikatën e datës 21.12.2015 të lëshuar

nga Shkolla për Integritime Europiane; Dëshmi e datës 26.11.2015; Certifikatën e datave 16 mars, 2 prill 2015 të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike; Certifikatën e datave 5,6 shkurt 2015 të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike; Certifikatën e datave 10-25 qershor 2013 të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike; Certifikatën e datave 5,6 maj 2014 të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike; Certifikatën me numër Nr.610 të lëshuar nga ZAS TRADE; Certifikatën me numër Nr.809 të lëshuar nga ZAS TRADE; Certifikatën maj 2013 të lëshuar nga Instituti i Administratës Publike dhe GIZ; Certifikatën e datave 25,26 qershor 2014 të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike; Certifikatën e datave 19,20 dhjetor 2012 të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike; Certifikatën 13 maj të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike; Kontratën për Veprën të datës 30 Maj 2014; Kontratën për Veprën të datës 22 Maj 2013; Kontratën mbi Veprën të datës 30.11.2012; Akt Emërimit e datës 01.01.2015; Vendimin me numër protokoll Nr.prot.1904 të datës 05.06.2023; Vendimin me numër protokoll Nr.prot.767 të datës 02.03.2023; Kopjen e letërnjoftimit; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë Drejtues i mesëm, i Ulët dhe Profesional i datës 31.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022 periudha Janar-Maj i datës 30.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022 periudha Qershor-Dhjetor i datës 30.01.2023; Vërtetimin e datës 12.06.2023 të lëshuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore/Ministria e Financave; Njoftimin për kandidatin fitues të datës 31.08.2023; Njoftimin përfundimtar të procedurës me numër protokoll Nr.prot.2946 të datës 12.09.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është *e pabazuar sepse*:

Ankuesja ka parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër Nr.2941 të datës 11.09.2023 të Komisionit për Vlerësimin për Ngritje në Detyrë në Ministrinë e Ekonomisë me pretendimet ankimore se përbërja e Komisionit të Vlerësimit për ngritje dhe avancim në detyrë në Ministrinë e Ekonomisë është në kundërshtim me Ligjin me numër Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, sepse Udhëheqësi më i lartë administrativ i Ministrisë së Ekonomisë themeloi Komisionin për Vlerësim duke e caktuar veten si Kryesuese të Komisionit; gjithashtu është shkelur Rregullorja (QRK) Nr.16/2020 për Pranim në Karrierën në Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, sepse në vlerësimin e intervistës me gojë si Kryesuese e Komisionit të Vlerësimit për Ngritje dhe Avancim në Detyrë u paraqiti Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Ekonomisë; është shkelur edhe nenin 29 i Ligjit me numër Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse Zv. Sekretarja e Përgjithshme duke caktuar vetën si kryesuese të Komisionit të Vlerësimit ka vënë në dyshim paanshmërinë e saj; po ashtu Komisioni i Vlerësimit për ngritje dhe avancim në detyrë ka bërë shkelje edhe të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik përkatësisht nenin 5 paragrafi 5 dhe nenin 8 paragrafi 3 si dhe Ligjin Nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi duke e shfuqizuar Vendimin me numër protokoll Nr.prot.768 të datës 02.03.2023, përmes së cilit kam ushtruar detyrën e Udhëheqësit të Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjeve, Mbështetjes Ligjore dhe Bashkëpunimit Ndërinstitucional në fushën e Legjislacionit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se sipas Konkursit me numër Reference: RN00011647 për ngritje (avancim) në detyrë për pozitën e punës „Udhëheqës i Divizionit

për Mbikëqyrjen dhe Zbatimin e Legjislacionit" në Departamentin Ligjor të Ministrisë së Financave, si kriteret të përgjithshme formale kanë qenë:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve. Fakulteti Juridik*
- *Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.*

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se përbërja e Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë ka qenë në kundërshtim me legjislacionin përkatës ngase në cilësinë e Kryesueses së Komisionit të vlerësimit ka qenë Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Ekonomisë dhe njëjta duke e caktuar vetën si Kryesuese të Komisionit e ka vënë në dyshim paanshmërinë e saj dhe ka bërë shkelje të Ligjit me numër Nr.06/L-011 për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Kolegji i Këshillit i 'u referua nenit 59 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se: „ 59. Komisioni i vlerësimit për ngritjen në detyrë . 1.Në tekstin e mëtejme: "KVND") themelohet për secilën procedurë konkurrimi për ngritjen në detyrë. 2 KVND themelohet nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit, me propozim të NJBNJ. 3.KVND ka në përbërje këta anëtarë: 3.1. një përfaqësues i Njesisë Përgjegjëse (DMZP-ja për institucionet e administratës shtetërore apo Njësia e Burimeve Njerëzore të Institucionit për institucionet e tjera shtetërore) i specializuar në teknikat e përzgjedhjes. 3.2. një përfaqësues nga NJBNJ e vetë institucionit që ka pozitën e lirë; 3.3. një nëpunës civil i kategorisë të lartë drejtuese të vetë institucionit apo të një institucioni tjetër të shërbimit civil, me përgatitje të veçantë në procedurat e përzgjedhjes”, andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses në këtë rast është i paqëndrueshëm sepse sipas dispozitave të lartpërmendura Komisioni i vlerësimit për ngritjen në detyrë **propozohet nga Njësia e Burimeve Njerëzore**, ndërsa themelohet nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit, dhe po ashtu gjithnjë sipas kësaj dispozite nuk është e ndaluar që **nëpunësi civil i kategorisë të lartë drejtuese të vetë institucionit** të jete anëtar i Komisionit andaj ne rastin konkret përbërja e Komisionit për Vlerësimin për Ngritje në Detyrë në Ministrinë e Ekonomisë i themeluar sipas Vendimit me numër Nr.2941 të datës 11.09.2023 është ne pajtim me nenin 59 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor se Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Ekonomisë duke e caktuar vetën si Kryesuese të Komisionit e ka vënë në dyshim paanshmërinë e saj dhe ka bërë shkelje të Ligjit me numër Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk ka kompetence lidhur me vlerësimin e ekzistimit e mundshëm të konfliktit të interesit, gjegjësisht lidhur me ekzistimin e mundshëm të konfliktit të interesit palët ne procedure mund të marrin opinion ligjor nga organi kompetent respektivisht Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor të ankueses për vlerësimin e jetëshkrimit konkretisht pretendimit se Komisioni për Vlerësim nuk i ka bërë vlerësim real dhe të drejte gjegjësisht nuk ka marrë për bazë shkollimin dhe trajnimet e shumta si dhe publikimet shkencore të saj , Kolegji i Këshillit, ne baze të dëshmitëve të ofruara nga palët konstatoi faktin se si kritere të përgjithshme formale që ndërliidhen me arsimimin e kërkuar ka qenë *Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3*

vite të studimeve-Juridik, e që në këtë kuptim në këtë konkurs nuk është kërkuar si kriter përgatitja profesionale e studimeve të Doktoratës, nga rrjedhë se edhe kandidatët në këtë procedurë nuk janë vlerësuar sa i përket këtij kualifikimi por janë vlerësuar vetëm sa i përket kualifikimit të studimeve së paku prej tri (3) vitesh. Duke marr parasysh provat e lëndës, konkretisht aplikacionin e ankueses dhe dëshmitë e dërguar nga e njëjta sa i përket përvojës së punës e njëjta ka bashkangjitur, Vendimin me numër protokolli Nr.prot.768 të datës 02.03.2023 përmes së cilit ankuesja është caktuar në pozitën e punës „Zëvendësuese e Udhëheqëses së Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjeve, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit ndër Institucional në Fushë“; Vendimin me numër protokolli Nr.prot.146 të datës 24.06.2022 me të cilin ankuesja është caktuar në pozitën e punës „ Zëvendësuese e Udhëheqëses së Divizionit për Hartimin dhe harmonizimin e Legjislacionit“ në Departamentin Ligjor; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit me shifër FROM: MAP/AE/02 të datës 02.02.2015 për pozitën e punës „ Zyrtare e Lartë Ligjore“ në Departamentin Ligjor të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit me shifër FROM: MAP/AE/02 të datës 05.12.2011 për pozitën e punës „Shef i Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm“ në Zyrën e Sekretarit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik; Akt Emërimit të datës 01.09.2011 për pozitën „Zyrtare e Lartë“ në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik; Kontratën e Marrëdhënies së Punës me numër kontrate: 115 të datës 01.09.2006 afati i skadimit më datë 31.08.2008 me të cilën dëshmohet se ka mbajtur pozitën e punës „Asistente Administrative“ në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave; Kontratën e Marrëdhënies së Punës me numër kontrate: 115 të datës 02.09.2009 dhe me afat skadimi 31.08.2011 me të cilën dëshmohet se ankuesja ka mbajtur pozitën e punës „Asistente Ekzekutive“ në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave; Kontrata e Marrëdhënies së Punës me numër kontrate: 115 të datës 20.10.2010 dhe me afat skadimi më datë 31.08.2011 me të cilën dëshmohet se ka mbajtur pozitë e punës „Zyrtare për të Drejtat e Minoriteteve“ në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, gjithashtu për sa i përket trajnimeve dhe publikimeve shkencore, ankuesja në aplikacionin e saj ka bashkangjitur: Certifikatën të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike për periudhën kohore prill-maj 2013 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar modulën e trajnimit „Procedurat e përgjithshme në drejtësinë administrative“; Certifikatën me numër Nr.872/12 të lëshuar nga English Language Centre me të cilën dëshmohet se ka ndjekur 120 orë për gjuhë Angleze të Avancuar; Certifikatën e lëshuar nga MDA më datë 29.05.2012, me të cilën dëshmohet se ka marrë pjesë në seminarin me temën „Marketing 3.0- Value Basted Marketing“; Certifikatën e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike me të cilën dëshmohet se me datat 1,2,8 dhe 9 tetor 2018 ka marrë pjesë në modulën e trajnimeve me temat „Planifikimi Strategjik, Vlerësimi i Ndikimit, Partneriteti dhe Konsultimet Publike, Menaxhimi i Zbatimit“ ; Certifikatën të lëshuar nga Universiteti Haxhi Zeka-Pejë me të cilën dëshmohet se ka marrë pjesë në „International Conference“ me datën 1 dhe 2 Nëntor 2018; Certifikatën e lëshuar nga USAID dhe A.U.K për muajin Qershor me të cilën dëshmohet se ka përfunduar trajnimin me temën „Public Policy Development and Leadership“, Certifikatën e lëshuar 05.03.2020 nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike me të cilën dëshmohet se ankuesja është certifikuar si Trajnerë i IKAP-it; Certifikatën e lëshuar nga CBE më datë 01.06.2012 me të cilën dëshmohet se ka marrë pjesë në seminarin me temën „Hoë to përpape documentation to apply for EU funds and effective cost-management“; Certifikatën e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike me të cilën dëshmohet se ka marrë pjesë në trajnimin me temën „ Klasifikimi i vendeve të punës në SHCK“ më datë 23 dhe 24 korrik 2012; Certifikatën e lëshuar nga Prudencia Consulting me të cilën dëshmohet se ka marrë pjesë në trajnimin me temën

„Procedura e përgjithshme administrative“ prej datës 16.02.2018 deri më 19.2018; Certifikatën e lëshuar nga ICD me të cilën dëshmohet se ka marrë pjesë në seminarin me temën „ Efficient Human Resources Management, Management Resources and IT Managment“ të organizuar më datë 21 dhe 24 Nëntor, 2007; Certifikatën e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike me të cilën dëshmohet se ka ndjekur modulën e trajnimeve me temën „Procedurat e Përgjithshme Administrative“ në muajin Janar-Maj 2013; Certifikatën e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike me të cilën dëshmohet se ka marrë pjesë në trajnimin me temën „ Përafrimi i Legjislacionit Vendor me Legjislacionin e Lashkimit Evropian“ më datë 21,22 dhe 23 Qershor 2016; Certifikatën e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike me të cilën dëshmohet se ka marrë pjesë në trajnimin me temën „Ligji për Administratën Shtetërore“ më datë 13 dhe 14 Tetor 2011; Certifikatën e lëshuar nga Progress Training Center me të cilën dëshmohet se ka marrë pjesë në trajnimin me temën „ Menaxhimi dhe Efikasiteti i Punëve në Zyre“ më datë 10,11,12 dhe 13 Tetor 2014, prandaj sa i përket pjesës së vlerësimit të jetëshkrimit ankuesja nga Komisioni Vlerësues është vlerësuar më tetëmbëdhjetë e tridhjetë e tre (18.33) pikë , nga 20 piket e mundshme për pjesën e jetëshkrimit, konkretisht në baze të listës përfundimtare ankuesja në pjesën e vlerësimit të jetëshkrimit është vlerësuar me se shumti pike në krahasim me kandidatet tjerë, kurse sa i përket pikëve të përgjithshme ankuesja në baze të njoftimit përfundimtar të procedurës me numër protokollit 2946 të datës 12.09.2023 të publikuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Ekonomisë ka arritur të grumbullojë gjithsejtë shtatëdhjetë e nëntë (79) pikë të përgjithshme, konkretisht në testin me shkrim është vlerësuar me pesëdhjetë e tre (53) pikë, në vlerësimin e jetëshkrimit është vlerësuar me tetëmbëdhjetë e tridhjetë e tre (18.33) pikë dhe në intervistën me gojë e njëjta është vlerësuar me shtatë e gjashtëdhjetë e shtatë (7.67) pike.

Ndërsa sa i përket vlerësimit të kandidatës fituese D.K, Kolegji i Këshillit Konstaton se e njëjta në fushën e testimit me shkrim është vlerësuar me gjashtëdhjetë (60) pikë, ndërsa sa i përket vlerësimit të jetëshkrimit e njëjta është vlerësuar me shtatëmbëdhjetë e gjashtëdhjetë e shtatë (17.67) pikë, ngase sa i përket kualifikimeve e njëjta posedon, Diplomën me numër Nr.1354 të lëshuar më datë 24.03.2021 nga Universiteti i Prishtinës me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet Master në Fakultetin Juridik/ Programi Kushtetues Administrativ më datë 20.02.2017, sa i përket përvojës së punës kandidatja fituese D.K sipas Vendimit me numër protokollit Nr.prot.02/1904 të datës 05.06.2023 të lëshuar nga Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme është caktuar Zëvendësueses e Udhëheqëses së Divizionit për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit në kuadër të Departamentit Ligjor në Ministrinë e Ekonomisë; Vendimit me numër protokollit Nr.prot.02/767 të datës 02.03.2023 të lëshuar nga Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme është caktuar Zëvendësueses e Udhëheqëses së Divizionit për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit në kuadër të Departamentit Ligjor në Ministrinë e Ekonomisë; Akt Emërimit të datës 01.01.2015 përmes së cilit dëshmohet se ka mbajtur pozitën e punës „Zyrtare e lartë Ligjore“ në Departamentin Ligjor në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik; Kontratën për Veprën të datës 30.11.2012 përmes së cilës është caktuar në pozitën e punës „Zyrtare Ligjore“ në Departamentin Ligjor në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik; Kontratën për Veprën të datës 22.05.2013 përmes së cilës është caktuar në pozitën e punës „Zyrtare Ligjore“ në Departamentin Ligjor në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik; Kontratën për Veprën të datës 30.05.2014 përmes së cilës është caktuar në pozitën e punës „Zyrtare Ligjore“ në Departamentin Ligjor në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, ndërsa sa i përket fushës së trajnimeve e njëjta ka bashkangjitur Certifikatën të lëshuar më 02,03 Dhjetorë 2015 nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike me të cilën dëshmohet se ka marrë

pjesë në trajnimin me temën „Korniza e përbashkët e Vetë-Vlerësimit (KPV)”; Certifikatën të lëshuar më datë 10 - 25 Qershor 2013 nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike me të cilën dëshmohet se ka marrë pjesë në trajnimin me temën „ Instrumenti i para anëtarësimit (IPA), Menaxhimi i ciklit të projekteve (MCP), Përgatitja e termave të referencës (TER)”; Certifikatën të lëshuar më datë 05-06 maj 2014 nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike me të cilën dëshmohet se ka marrë pjesë në trajnimin me temën „ E Drejta e BE-së dhe Zbatimi i Saj”; Certifikatën e lëshuar për periudhën kohore Janar-Maj 2013 nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike dhe Organizata GIZ me të cilën dëshmohet se ka përfunduar modulën e trajnimit „ Ligji për procedurën Administrative”; Certifikatën të lëshuar më datë 25-26 Qershor 2014 nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike me të cilën dëshmohet se ka përfunduar trajnimin me temën „Përafrimi i Legjislacionit Vendor më Legjislacionin e Bashkimit Evropian”; Certifikatën të lëshuar më datë 19-20 Dhjetorë 2012 nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike me të cilën dëshmohet se ka marrë pjesë në trajnimin me temën „Përafrimi i Legjislacionit Vendor më Legjislacionin e Bashkimit Evropian”; Certifikatën e lëshuar më datë 13.05.2013 nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike me të cilën dëshmohet se ka marrë pjesë në trajnimin me temën „ Hartimi i Legjislacionit”; Certifikatën me numër Nr.610 të lëshuar më datë 25.04.2013 nga Zas Trade-Center me të cilën dëshmohet se ka përfunduar kursin e gjuhës angleze në nivelin A2; Certifikatën me numër Nr.610 të lëshuar më datë 15.01.2013 nga Zas Trade-Center me të cilën dëshmohet se ka përfunduar kursin e gjuhës angleze në nivelin A1, ndërsa në intervistën me gojë kandidatja D.K është vlerësuar me dhjetë (10) pikë, andaj kandidatja e përzgjedhur D.K ne baze të njoftimit përfundimtar të procedurës me numër protokoli 2946 te datës 12.09.2023 te publikuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore te Ministrisë se Ekonomisë ka arritur te grumbulloje gjithsejtë tetëdhjetë e shtatë e gjashtëdhjetë e shtatë (87.67) pikë te përgjithshme nga tri fazat e vlerësimit.

Kolegji i Këshilli, nga shqyrtimi i provave të lëndës, respektivisht ndërlidhur me vlerësimin e kandidatëve në fazën e testit me shkrim, jetëshkrimit dhe intervistës me gojë, konstaton se testimi me shkrim është elektronik dhe kandidatët vlerësohen në bazë të përgjigjeve të dhëna, ndërsa vlerësimi bëhet sipas sistemit elektronik, sa i përket vlerësimit të jetëshkrimit, Kolegji i Këshillit, sipas arsyetimit të cekur si më lartë, konstaton se vlerësimi i jetëshkrimit për ankuesen dhe kandidaten fituese është bërë mbi bazën e provave të dërguar nga palët, ndërsa vlerësimi i intervistës me gojë është vlerësim diskrecional i Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë, ngase ky vlerësim bëhet në bazë të vlerësimit të përgjigjeve që benë komisioni, kështu që duke marr parasysh faktet e lartpërmendur Kolegji i Këshillit, konstaton se vlerësimi i kandidatëve është bërë në pajtim me nenin 60, 61 dhe 62 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, andaj pretendimi i ankueses është i pabazuar.

Marr parasysh këtë konstatim, Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me Nr. 2941 i datës 11.09.2023 i Komisionit për Vlerësimin për Ngritje në Detyrë në Ministrinë e Ekonomisë, është vendim i drejtë dhe i ligjshëm dhe i njëjti plotëson kushtet e aktit administrativ, ndërsa pretendimet e ankueses ndaj këtij akti janë të pabazuara.


Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit te të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1266/2023 më datë 10.10.2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj


Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërrkohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.